

**STATUT - AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“ ABACO CONSULTING SH.P.K.”

Ne Tirane, sot me datën 26.09.2023 (dy mijë e njëzet e tre)

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortaket Themelues**

- 1.1 Shoqëria themelohet nga pese Ortake si më poshtë:
- a) Ne Tirane, sot me datën 26.09.2023 (dy mijë e njëzet e tre) shtetasi **Sejma Skendo** e bija e Luan Skendo, e datelindjes 29.08.1983 lindur ne Elbasan dhe banuese ne adresën Via Samuele Biava, nr 25 Bergamo, Itali, kodi postar 24123, me karte identiteti numer CA41203KJ.
Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:
Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.
- b) Ne Tirane, sot me datën 26.09.2023 (dy mijë e njëzet e tre) shtetasi **Erjona Rama** i bija e Ilir Rama, e datelindjes 23.06.1981 lindur ne Lezhe dhe banues ne adresën Via Guglielmo Oberdan nr 53, Genova Itali Kodi postar 16167, me karte identiteti numer CA27371LJ.
Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:
Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.
- c) Ne Tirane, sot me datën 26.09.2023 (dy mijë e njëzet e tre) shtetasi **Ana Dhonato** e bija e Orest Dhonato, e datelindjes 10.10.1971 lindur ne Kavaje dhe ne adresën Via Palazzetto, nr 57/b Prata di Pordenone, Itali, kodi postar 33080, me karte identiteti numer CA86997AO.
Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:
Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.

Erjona Rama
Sejma Skendo
Ana Dhonato

Erjona Rama
Sejma Skendo
Ana Dhonato

d) Ne Tirane, sot me datën 26.09.2023 (dy mijë e njëzet e tre) shtetasi **Eriglina Begaj** e bija e Asqeri Blliku, e datelindjes 06.07.1984 lindur ne Lushnje dhe banuese ne adresën Via Cimarosa, nr 2 Parma, Itali, kodi postar 43123, me karte identiteti numer AY1765667.

Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:

Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.

e) Ne Tirane, sot me datën 26.09.2023 (dy mijë e njëzet e tre) shtetasi **Anela Kurshumi** e bija e Halil Kurshumi, e datelindjes 16.12.1978 lindur dhe banues ne adresën Via degli Scalini, nr 5/4 Bologna, Itali, kodi postar 40126, me karte identiteti numer CA89611BQ.

Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:

Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.

Neni 2 Emri

2 Emri i shoqërisë është “ **ABACO CONSULTING SH.P.K.**” (më poshtë referuar si “Shoqëria”)

Neni 3 Selia e Shoqërisë

3 Selia e Shoqërisë është: **Zona Kadastrale 8380, Njesia administrative nr 10, Rruga Islam Alla, Nr 4/700- N14, Kati i 2 te, Tirane**

3.1 Shoqëria mund te hapë degë, përfaqësi, zyra dhe njësi operative në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit.

Neni 4 Forma ligjore

4.1 Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 5 Vula, Stema

5.1 Shoqëria “Abaco Consulting Sh.p.k.” ka vulën e saj mbi të cilën ka shruar emërtin e saj.

5.2 Stema “Abaco Consulting” Sh.p.k duhet te figuroj në të gjithë materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të Shoqërisë.

Eriglina Begaj
Sheudo Sejma
Alicia Dronits

Abaco

Kurshumi Anela
Roma Ejona

Neni 6 Kohëzgjatja

6.1 Shoqëria do të zhvilloj veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

Neni 7 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

7.1 Shoqëria "Abaco Consulting" Sh.p.k. ushtron veprimtarinë e saj, me qëllim realizimin e fitimit duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Veprimtaria e Shoqërisë "Abaco Consulting" Sh.p.k. do të ketë për objekt: Asistencë kontabile, regjistrim të dhënash kontabël, konsulencë në fushën fiskale, konsulencë manaxheriale dhe organizative, rekrutim dhe trajnim profesional si dhe shërbime të lidhura me to. Kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit. Shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet që do të konsiderohen të nevojshme për përmbushjen e objektit të saj; Shoqëria mund të ketë pjesëmarrje në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm sipas legjislacionit shqiptar shërbime profesionale marketingu dhe promocion në web dhe platforma digjitale. Konceptim dhe permisim i brandit të shoqërisë dhe krijimi i identitetit tregtar.

Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria me vendim të Organit Administrues mund të lidhë marrveshje tregtare apo bashkpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet me qëllim arritje e objektit të veprimtarisë së saj.

7.2 Objekti i shoqërisë mund të ndyshojë, të zgjerohet ose të reduktohet në bazë të vendimit të Asemblesë së Përgjithshme.

PJESA II KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT

Neni 8 Kapitali i Shoqërisë

8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë "Abaco Consulting" Sh.p.k është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe është plotësisht i paguar.

8.2 Kapitali do të ndahet në 5 (pesë) kuota dhe vlera e nje quote eshte 20 000 leke

8.3 Ky kapital është formuar nga themeluesit e shoqërisë si me poshtë:
ku vlera nominale e një kuote është 20 000 (njezet njëmijë) lekë per ortaken Sejma Skendo , 20 000 (njezet njëmijë) lekë per ortaken Erjona Rama , 20 000 (njezet njëmijë) lekë per ortaken Ana Dhonato , 20 000 (njezet njëmijë) lekë per ortaken Eriglens Begaj dhe 20 000 (njezet njëmijë) lekë per ortaken Anela Kurshumi.

Eriglens Begaj
Sejma Skendo
Ana Dhonato

Anela Kurshumi

Erjona Rama
Anela Kurshumi

8.2. Kuotat mund t'i transferohen lirisht ortakeve ose edhe te treteve qe nuk jane ortake te shoqerise. Ortakeve ekzistues i perket e drejta e parablerjes se kuotave objekt transferimi. Per "transferim" nenkuptohet cdo veprim ligjor si me pagese ashtu dhe falas sic mund te jete shitja, kembimi, dhurimi e veprime te tjera te ngjashme qe transferojne plotesisht ose pjeserisht te drejtat, qe i perkasin kuotes.

Ortakut qe do te shese kuoten ose nje pjese te saj me ane te nje komunikimi me shkrim duhet t'ja propozoje per shitje paraprakisht ortakeve ekzistues, me perjashtim te rastit kur keto kane dhene paraprakisht miratimin per transferimin e kuotes me shkrim. Komunikimi duhet te cilesoje te dhenat personale te blesesit, vleren e shitjes dhe menyren e pageses. E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet brenda 30 ditesh nga marrja e ofertes duke i komunikuar me shkrim propozuesit vendimin e tij.

Kontratta e transferimit te kuotave duhet te behet me shkrim dhe vetem me akt noterjal dhe ne baze te formaliteteve te miratuara nga Organi Drejtues. Transferimi i kuotes i komunikohet shoqerise.

Nese transferimi i kuotes behet pa respektuar c'parashikon ky nen atehere ai nuk ka vlere per shoqerine dhe blesesi i kuotes nuk gezon te drejten e votes dhe te drejtat e tjera administrative qe i perkasin kuotes.

Transferimi i kuotave te treteve, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, behet me vendim te kualifikuar te ortakeve te shoqerise qe perfaqesojne mbi 80% te kuotes te kapitalit themeltar. Ortakut qe don te shese kuoten ne kete rast nuk voton.

Ne rast vdekjeje te ortakut, ortakut e tjere vendosin me vote te kualifikuar (me shume se 80% te kapitalit themeltar) nese te pranojne si ortake, trashgimtaret e ortakut te vdekur. Nese nuk vazhdohet aktiviteti me trashgimtaret, ketyre i takon liquidimi i kuotes sipas nenit 17 brenda 6 muajsh nga data e vdekjes te ortakut ose e pranimit te trashgimise.

8.3. Asambleja e pergjithshme mund te vendosi zmadhimin e kapitalit, me vendim te kualifikuar (80%), duke emetuar kuota te reja ne favor te ortakve ekzistues me shumate qe percaktohen ne vendimin e marre prej saj. I njejti vendim i kualifikuar kerkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit ka qellim te jape mundesi ortakeve te rinj te hyjne ne shoqeri.

Po me vendim te kualifikuar shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj.

III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Engleue Begaj
Sherudo Sejma
Ajina Donato

Kushni Ajala
Lama Ajana

Neni 9 Organet drejtuese

- 9.1 Organet drejtues të shoqërisë “Abaco Consulting” Sh.p.k. janë:
- Asembleja e Përgjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë
 - Organi Administrativ.

Neni 10 Asembleja e përgjithshme

- 10.1 Vendimet merren nga Asembleja e Përgjithshme, e cila merr vendime për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e Asemblesë së Përgjithshme.
- 10.2 Asembleja thirret nga Organi Administrues me njoftim me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike sipas afateve ligjore.
- 10.3 Asembleja zhvillon mbledhjet e saj në Shqipëri ose jashtë saj ne prezence ose ne videokonference.
- 10.4 Përvec rasteve të miratimit të llogarisë vjetore si dhe ndryshimeve të Statutit, Asembleja mund të marrë vendime edhe me anë të konsultimit me shkrim të ortakëve. Organi i administrimit vendos mbi zgjedhjen e formës së marrjes së vendimeve me ane te konsultimit me shkrim.

Neni 11 Marrja e vendimeve

- 11.1 Cdo ortak, pavarësisht nga numri i pjesëve të kapitalit që zotëron, ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe në vendimet e assemblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.
- 11.2 Cdo ortak ka të drejte të përfaqësohet në keto mbledhje nga një ortak tjetër ose nga një mandatmbajtës i cili mund të votojë në emër të atij që përfaqëson. Mandati i përfaqësimit nuk mund të jetë i përhershëm por jepet vetëm për një mbledhje të Asemblesë. Mandati i dhënë për një mbledhje të Asemblesë është i vlefshëm për mbledhjet e tjera që thirren si vazhdim i së parës dhe me të njëjtin rend dite.
- 11.3 Asembleja mund te marre vendime nese jane prezente ortake qe perfaqesojne me shume se 50% te kapitalit themeltar te shoqerise. Vendimet merren nese aprovohen me votat qe perfaqesojne me shume se 50% te kapitalit themeltar, me perjashtim te pikave a), b), c), g) te nenit 12.1 , qe merren me aprovimin e votave te atyre qe perfaqesojne me shume se 80% te kapitalit themeltar.

Neni 12 Kompetencat e Asemblese se Ortakeve

- 12.1 Janë në kompetencën ekskluzive të Asemblesë së Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:
- Ndryshimit të Statutit

Eriglene Begej
Shendol Sejnoc
Amir Dranota

Kushnir Ajele
Rama Ejona

- b. Riorganizimi i shoqërisë ndarja, bashkimi, likuidimi.
- c. Zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët dhe blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar nga vetë shoqëria me qëllim anulimin e tyre
- d. Miratimi i raportit vjetor dhe raporti i ekspertëve kontabël të autorizuar
- e. Emërimi dhe shkarkimi i Administratoreve
- f. Emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të autorizuar
- g. Shndërrimi i Shoqërisë në një formë tjetër
- h. Si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Asemblesë

PJESA IV
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE DHE TE DREJTAT DHE DETYRAT
E ORTAKEVE TE SHOQERISE

Neni 13
Administrimi i Shoqerise

- 13.1 Shoqeria administrohet nga nje Organ Administrimi qe mund te perbehet nga nje deri ne 5 persona fizike qe edhe mund te mos jene ortake te Shoqerise.
- 13.2 Organi administrues eshte i detyruar te drejtoje Shoqerine "Abaco Consulting" Sh.p.k. ne perputhje me ligjin 9001 date 14.04.2008 per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, me kete statut dhe me vendimet e Asemblese se Pergjithshme sipas dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

Neni 14
Emerimi dhe shkarkimi i Administratorit

- 14.1 Organi Administrues emerohet dhe shkarkohet nga Asembleja e Ortakeve dhe qendron ne detyre per nje kohe prej 3 (tre) vjetesh. Personat e zgjedhur kane te drejten e rizgjedhjes. Nese Organi Administrues eshte i perbere nga me shume se nje person atehere administratoret zgjedhin Kryetarin e Keshillit Administrues, nese ky i fundit nuk eshte zgjedhur nga Asambleja pergjithshme qe emeron Organin Administrues.
- 14.2 Administratori i pare i shoqerise eshte Odise Jorgji, i datelindjes 13.07.1956, lindur ne Gjirokaster, banues ne Tirane Rr. Memo Meto, pallati 59/7 shll.1 nr.21.
- 14.3 Organi Administrues ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statusi i Shoqerise

Neni 15
Kompetencat e Administratorit

Engleua Begej *Enje* *Kurhani*
Shenda Pejuna *Rama Ejona*
Arena Jhonata

15.1 Organi Administrues ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në emer dhe për interes të Shoqërisë "Abaco Consulting" Sh.p.k. me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Asemblese së Përgjithshme.

15.2 Organi Administrues përfaqëson Shoqërinë për të tretëve dhe të gjitha vendimet manaxheriale të Shoqërisë "Abaco Consulting" Sh.p.k. duhet të nënshkruhen nga Administratori ose Kryetari i Këshillit Administrues. Nëse Organi Administrues është i përbërë nga më shumë se një person atëherë është Kryetari i Këshillit Administrues, ose një person me prokurë nga ky i fundit që përfaqëson shoqërinë dhe firmos të gjitha vendimet manaxheriale të Shoqërisë.

15.3 Duhet autorizuar nga Asembleja e Ortakëve çdo operacion ose lidhje kontratash të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për Shoqërinë apo që përcaktojnë për shoqërinë një pagesë shumë mëbi leke 1.000.000.

15.3 Administratorëve mund t'i njihet, me vendim të Asemblese së përgjithshme, një shpërblim për punën e tyre dhe për mbylljen e mandatit. Administratorët kanë të drejtën e rimbursimit të të gjitha shpenzimeve që ato bëjnë personalisht në ushtrimin e detyrës së administratorit.

Neni 16

Vendimet e Organit Administrues

16.1 Mbledhjet e Organit Administrues mbahen sa herë të paraqitet e nevojshme në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë. Mbledhjet e Organit Administrues mund të fillojnë punimet nëse janë prezent më shumë se 50% të anëtarëve.

16.2 Organi Administrativ mund të kryejë mbledhjet edhe nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit sipas procedurës që duhet shpjeguar në procesverbal. Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i Administratorëve, dhe në mungesë të tij, nga personi i emëruar si kryetar i mbledhjes nga prezentet. Këtu të fundit zgjedhin gjithashtu dhe sekretarin e mbledhjes. Vendimet merren me votën e shumicës së prezenteve, me përjashtim të rastit kur prezentet janë dy, rast në të cilin vendimi merret sipas votës së shprehur nga kryetari i mbledhjes.

Nuk lejohet dhenja e mandatit për marrje pjesë në mbledhjet e Organit Administrues.

16.3 Vendimet e Organit Administrues hidhen me shkrim në librin përkatës dhe firmosen nga Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari.

Neni 17

Doreheqja e ortakut

17.1 Ortaku ka të drejtë të japë doreheqjen nga shoqëria :

- kur nuk është dakort me:

- ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë ose të llojit të shoqërisë,
- me bashkimin ose ndarjen e shoqërisë,
- anulimin e vendimit për likuidim të shoqërisë,
- eliminimin ose shtesën e një nga arsyeve të doreheqjes së ortakut të parashikuar nga ky statut,
- të ndryshimit të nënëve të parashikuara nga ky statut për transferimin e kuotave

Erigjere Begaj
Shendo Sejmuo
Arena Donato

Kushini Anela
Rama Ejano

- ne te gjitha rastet e tjera parshikuar ne ligj
- nese shoqeria eshte me afat ta pacaktuar, ne cdo moment pas tre vjetesh nga krijimi i shoqerise.

17.2 Dëshira e ortakut për të dhënë dorëheqjen nga shoqëria duhet komunikuar Organit Administrues me shkrim brenda 15 ditëve nga vendimi që ben të lind e drejta për dorëheqje, në rast se arsyeja e dorëheqjes është një vendim i marrë. Në rastet të tjera komunikimi duhet bërë brenda 30 ditësh nga data e njohjes së faktit që ben të lindë e drejta e dorëheqjes.

17.3 Ortaku që jep dorëheqjen ka të drejtën e liquidimit të kuotes në proporcjon me kapitalin e shoqërisë brenda 6 muajsh nga data e komunikimit sipas paragrafit 17.1. Administratori në përcaktimin e vlerës së kuotes i referohen vlerës reale të saj, vlerë e përbërë nga kuota nominale si dhe avviamento.

Neni 18 Mosmarreveshjet

18.1 Për të gjitha mosmarreveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim organi kompetent do të jetë Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.

18.2 Ky statut redaktohet në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Neni 19 Te pergjithshme

19.01 Për të gjitha raportet me shoqërinë, adresën e ortakëve dhe e administratorëve është ajo që figuron në QKR dhe në ato adrese dërgohen të gjitha komunikimet parashikuar nga ky statut. Nëse parashikohet dhe komunikimi me mjete të tjera si fax, e-mail ose mjete të tjera komunikimi, komunikimet e parasikuara nga ky statut duhen bërë në numrin e fax-it, në adresën e-mail që ortakët i komunikojnë me shkrim Organit Administrues. Me këtë qëllim shoqëria mund të vendosë të mbaje librin e ortakëve ku të shënojë, përveç adresës postare, dhe të dhenat e tjera si numer fax-i, adresë e-mail e të tjera, që Organi Administrativ i mban të azhurnuar.

Neni 21 Regjistrimi ne QKB

20.1 Autorizohet znj. Eralda Mbrice për të kryer procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë "Abaco Consulting" Sh.p.k.

Lexuar kuptuar aprovuar e nënshkruar nga ortakët themelues

Egleme Begej
Shenado Sejuna
Arene Donato

Kushni Amelle
Lama Ejona

ORTAKET THEMELUES

SEJMA SKENDO

Sheudo Sejma

ERJONA RAMA

Rama Ejona

ANA DHONATO

Ana Dhonato

ERIGLENA BEGAJ

Eriglena Begaj Dufe.

ANELA KURSHUMI

Kurshumi Anela

